



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

RAPORT VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PERIUdhËN
JANAR – DHJETOR 2023

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1.Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këtu e në vijim, MSHMS) ka përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i Ligjit Nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për vitin 2023, janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (këtu e në vijim RENjKP) dhe/ose aktiviteteve të tjera konsultative, aktet e miratuara, si më poshtë¹:

1. Vendim Nr. 400, datë 05.07.2023 “Për propozimin e Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar”
2. Vendim Nr. 359, datë 16.06.2023 “Për propozimin e Projektligjit "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”
3. Vendim Nr. 380, datë 29.06.2023 “Për propozimin e Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar”.
4. Vendimi Nr. 732 , datë 13.12.2023, Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan paqen dhe sigurinë” 2023 -2027” në Republikën e Shqipërisë”.
5. Vendimi Nr. 308, datë 26.10.2023, Për propozimin e projektligjit për një shtesë dhe një ndryshim në Ligjin Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësohet se procesi, në raport me periudhën e kaluar (vitin 2022), paraqet një trend të kënaqshëm duke patur një numër të madh aktorësh të përfshirë, sidomos nga organizatat joqeveritare.

¹ Në kohën e hartimit të këtij raporti, projektligjet janë miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave për propozimin e tyre dhe gjenden në faqen e Parlamentit, në pritje për shqyrtim nga Komisionet përkatëse.

Takimet konsultative janë zhvilluar nëpërmjet platformave të ndryshme ndër to RENJKP, aplikacionet online dhe tryezat e përbashkëta duke respektuar masat e ndërmarra për parandalimin e Covid-19. Në këtë kontekst, indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM) është 100 % pasi të gjithë aktet e konsultuara i janë nënshtruar takimeve publike. (IPM = $4/4 \cdot 100 = 100\%$).

Në takime kanë marrë pjesë aktorë joqeveritarë të profileve të ndryshme si ekspertë të fushës, shoqata dhe organizata ndërkombëtare.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i akteve të miratuara si nismë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2023 është 26.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar të gjitha aktet mbi të cilat bie detyrimi ligjor për konsultim publik, në total 5 akte.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Janë konsultuar 4 akte, të shoqëruar me VNR:

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar"
2. Projektligji "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale"
3. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"
4. Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë".

Vendimi i konsultuar nuk është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyeja kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2023 për MSHMS parashikon 13 akte. Për sa i takon periudhës Janar – Dhjetor 2023, janë përdorur kriteret përjashtuese për konsultimin publik për 12 akte të PPAP. Arsyeja kryesore e

moskonsultimit të tyre është të qënit akte administrative normative të përgjithshme, të cilat nuk janë projekte strategjike apo projektligje.

I vetmi akt i konsultuar dhe pjesë e PPAP është projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar".

2.1.5. *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Janë konsultuar 4 projektligje dhe 1 projektvendim.

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar";
2. Projektligji "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale";
3. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar";
4. Vendimi Nr. 732, datë 13.12.2023 "Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan paqen dhe sigurinë" 2023 -2027" në Republikën e Shqipërisë";
5. Projektligji "për një shtesë dhe një ndryshim në ndryshim në Ligjin Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë".

2.1.6. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Në raport me periudhën korresponduese të vitit të kaluar vihet re rritje në raportin ndërmjet numrit të përgjithshëm të akteve të miratuara me ato të konsultuara.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 janë miratuar në total 29 akte dhe nga këto 2 janë konsultuar (6.89 %).

Për ndërkohë që për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 janë miratuar në total 17 akte dhe nga ato 3 janë konsultuar (17.64%).

Për gjashtëmujorin e dytë janë miratuar 6 akte dhe janë konsultuar 2 prej tyre.

Totali i akteve të miratuara për vitin 2023 është 23 dhe nga ato janë konsultuar 5 akte (21.7 %), të cilat janë objekt konsultimi sipas Ligjit Nr. 146/ 2014 "Për njoftimin dhe Konsultimin Publik".

Sillet në vëmendje se për aktet e tjera të lartpërmendura aplikohen dhe kriteret përjashtuese sipas Nenit 4, të Ligjit Nr. 146/ 2014 "Për njoftimin dhe Konsultimin Publik".

Situata mbetet njëlojtë si vitin e kaluar, duke mbajtur të njëjtin trend pozitiv për përfshirjen e aktorëve.

Në konsultimin e këtyre akteve janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, në disa platforma si RENjK, email, Zoom dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose dhe pse.

Hapat e procesit janë respektuar rigorozisht: Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENjKP), është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Për të gjithë projektaktet e konsultuara janë përdorur metoda të ndryshme konsultimi: tryeza e rumbullakët, e – mail, korrespondencë zyrtare, takime online dhe RENjKP.

1. Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar" është përdorur metoda e konsultimit publik nëpërmjet RENjKP.
2. Për projektligjin "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" janë përdorur metodatat e konsultimit nëpërmjet takime online dhe fizike, RENjKP-së, Këshillimit Kombëtar dhe diskutimeve ndërmjet anëtarëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me urdhër të Kryeministrit.
3. Për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" është përdorur metoda e konsultimit publik nëpërmjet RENjKP.
4. Për vendimin "Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan paqen dhe sigurinë" 2023 -2027" në Republikën e Shqipërisë", është përdorur metoda e konsultimit nëpërmjet RENjKP dhe takime online dhe fizike si dhe takime ndërmjet Organizatave ndërkombetare Un-Women, OSBE, Ambasada Amerikane, Ambasada Hollandeze, SIDA.
5. Vendimi Nr. 308, datë 26.10.2023 "Për propozimin e projektligjit për një shtesë dhe një ndryshim në ndryshim në Ligjin Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" është përdorur metoda e konsultimit nëpërmjet RENjKP dhe i është nënshtruar konsultimit të brendshëm me institucionet të tjera shtetërore.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi më shumë komente kanë qenë takimet online, e pasuar nga email-et dhe ajo më pak e përdorura është RENjKP.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Projektligji “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” u ndërmor në vijim të rezultateve të Këshillimit Kombëtar, ku nisma për legalizimin e kanabisit (kërpi) për qëllime mjekësore dhe industriale, është përfshirë në Këshillimin Kombëtar të iniciuar nga Kryeministri. 61% (308,992) e qytetarëve të konsultuar nëpërmjet këtij procesi u përgjigjën pozitivisht kësaj nisme.

Gjithashtu, rezultatet e Këshillimit Kombëtar për projektligjin e lartpërmendur ndikuan edhe në Projektligjin “Për disa shtesa në Ligjin Nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar” pasi ndryshimet e propozuara në këtë projektligj prekën edhe ato për bimën e kanabisit, krahas qëllimit kryesor që ishte përditësimi i tabelave të lëndëve narkotike e psikotrope.

Për projektvendimin “Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan paqen dhe sigurinë” 2023 -2027” në Republikën e Shqipërisë”, në qershor të vitit 2022, janë organizuar takime paraprake me nënpunësit për çështjet e barazisë gjinore, në nivel vendor dhe qendror mbi rekomendimet nga vlerësimi i strategjisë së mëparshme dhe diskutimi i qëllimit kryesor të strategjive të planit, si dhe takim parapërgatitor me OJF dhe KMD dhe Studiues akademike.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Të gjitha projektaktet janë konsultuar për më shumë se 20 ditë.

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar" ka zgjatur nga 26.04.2023 – 20.05.2023.

2. Projektligji "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" ka zgjatur nga 30.06.2022 – 10.03.2023.

3. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" ka zgjatur nga: 30.03.2023 - 29.04.2023.

4. Projektvendimi "Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan paqen dhe sigurinë" 2023 -2027" në Republikën e Shqipërisë", ka zgjatur nga data 18.05.2023 – 15.06.2023 (periudha që dokumenti ka qenë 137 i publikuar).

5. Vendimi Nr. 308, datë 26.10.2023 "Për propozimin e projektligjit për një shtesë dhe një ndryshim në ndryshim në Ligjin Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike më datë 18.05.2023 – 15.06.2023, me qëllim njohjen dhe konsultimin publik.

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë pesë muaj, ku konsultimi me kohëzgjatje më të madhe ka qenë Projektvendimi "Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan paqen dhe sigurinë" 2023 -2027" në Republikën e Shqipërisë" (një vit).

2.3.3. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në raport me periudhën korresponduese të vitit të kaluar është vënë re një rritje e përdorimit të Regjistrit Elektronik të Konsultimit Publik, si dhe një rritje në raportin ndërmjet numrit të përgjithshëm të akteve të miratuara me ato të konsultuara.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 janë miratuar në total 29 akte dhe nga këto 2 janë konsultuar (6.89 %) ndërkohë që për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 janë miratuar në total 17 akte dhe nga ato 3 janë konsultuar (17.64%). Për gjashtëmujorin e dytë janë miratuar 6 akte. Totali i akteve të miratuara për vitin 2023 është 23 dhe nga ato janë konsultuar 5 akte (21.7 %).

Sillet në vëmendje se për aktet e lartpërmendura aplikohen dhe kriteret përjashtuese sipas Nenit 4, të Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

Situata mbetet njëlojë si vitin e kaluar, duke mbajtur të njëjtin trend pozitiv për përfshirjen e aktorëve.

Në konsultimin e këtyre akteve janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, në disa platforma si RENJK, email, Zoom dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose refuzuar dhe arsyet pse.

Hapat e procesit janë respektuar rigorozisht: Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENjKP), është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në konsultimet e kryera gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 kanë marrë pjesë në konsultime aktorë të shumëllojshëm përfshirë këtu ekspertë të jashtëm të angazhuar drejtpërdrejtë në hartimin e projektaktit, si dhe ekspertë fushe që kanë dhënë komente nëpërmjet metodave të lartpërmendura të konsultimit, persona fizikë dhe juridikë privatë.

Veçojmë si më poshtë:

Numri i ekspertëve të jashtëm ka qenë 1 i dedikuar për Projektligjin "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale".

Gjithashtu po për këtë projektligji kanë përcjellë komente aktorë të ndryshëm si: Një grup informal, Legalize Albania², Shoqata Kombëtare Shqiptare e Industrisë së Kërpit³, Kaya Hemp Project in Albania⁴, Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri.

Ndërkohë për sa i takon Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar” ka përcjellë komente Redon Consulting nëpërmjet RENjKP-së.⁵

Për projektvendimin “Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan paqen dhe sigurinë” 2023 -2027” në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcjellë komente 1 ekspert i jashtëm për çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore, kostimit dhe buxhetimit të përgjithshëm gjinor, të cilat u mundësuan nëpërmjet mbështetjes së UN- Women. Gjithashtu kanë përcjellë komente Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi, Përfaqesuesja e OSBE.

² <https://legalize.al/la/>

³ <https://albaniahemp.org/>

⁴ <https://kaya.global/people-kaya/>

⁵ <https://redonconsulting.al/>

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Grupet e punës kanë përfshirë anëtarë nga MSHMS dhe nga institucione qendrore dhe ekspertë të jashtëm, të mundësuar nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare si GIZ. Projektligji "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" është hartuar dhe konsultuar në Grupin Ndërinstitucional të Punës, të ngritur me Urdhër të Kryeministrit, i cili ka përfshirë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuar për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Në total kanë marrë pjesë 54 të ftuar nga profile të ndryshme, si organizata ndërkombëtare, studiues të pavarur, subjekte ekonomike, veprimtaria e të cilëve fokusohet në projektligjin e publikuar për konsultim.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Në varësi të projektligjit të publikuar për konsultim ndryshon edhe struktura e personave që kanë përcjellë komente. Konkretisht:

- Projektligji "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabisit dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" kanë marrë pjesë si më poshtë:

- Në takimin konsultativ në Ministrinë e Brendshme kanë marrë pjesë grupet e interesit si media, partnerë për zhvillim, shoqëri civile dhe shoqata të toksikologëve;

- Në takimin e zhvilluar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë marrë pjesë grupet e interesit si kërkues shkencor për bimët medicinale, gjithashtu dhe përfaqësues të shoqatave shqiptare për industrinë e kanabis mjekësor (kërpit) e cila funksionon si filial zyrtar i shoqatës osmbrellë të BE-së në këtë fushë.

- Në takimin e zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë marrë pjesë përfaqësitë farmaceutike në vend.

Gjithashtu është konsultuar edhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri.

- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, komenti i përcjellë nëpërmjet RENJKP ka qenë nga një firmë konsulence për bizneset.

- Projektligj “Për disa shtesa në Ligjin Nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar” është publikuar në RENJKP, duke iu adresuar të gjithë personave të interesuar veçanërisht shoqata farmaceutike.
- Projektvendimi “Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan paqen dhe sigurinë” 2023 -2027” në Republikën e Shqipërisë” është publikuar dhe adresuar Ministrive të linjës, Njësive të veteqeverisjes vendore, nepunesve te barazisë gjinore dhe koordinatoreve /vendore kunder dhunes ne familje, Policisë së shtetit shqiptar, si dhe Institutit të Statistikave Zyrtare. Organizatave të shoqërisë civile , institucioneve të pavarura, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Organizatave nderkombetar UN-Women, OSBE, Ambasada Amerikane, Ambasada Hollandeze dhe SIDA.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Po, janë përfshirë më shumë aktorë, nga profile të ndryshme specialitetesh. Ndërkohë formatet për përgatitjen e akteve kanë kërkuar një punë më të specializuar prandaj janë përfshirë përveçse institucioneve shtetërore edhe ekspertë individualë të fushës.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Numri total i komenteve ka qenë 45. Mesatarja është 9 për çdo konsultim.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Jane pranuar 29 komente plotesisht, 9 komente te pranuar pjeserisht, 7 janë refuzuar.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Situata mbetet njëloj si për vitin e kaluar, duke mbajtur të njëjtin trend pozitiv për përfshirjen e komenteve nga aktorët.

Pozitive është se numri më i lartë i komenteve ka ardhur nga profesionistët e fushës, si industria e kërpit, studiuesit e fushës së bimës së kanabis etj.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Për të katër projektligjet e propozuar janë ndryshuar VNR-të shoqëruese për shkak të komenteve të përcjella, duke qenë se ka ndryshuar përmbajtja e draftit të projektligjit ose janë dhënë sqarime të mëtejshme mbi procesin e konsultimit dhe arsyeve të ndërmarrjes së nismës.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar 5 raporte konsultimi.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Institucioni i ka publikuar të 5 raportet e konsultimit publik.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

(Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

MSHMS vlerëson se konsultimi i të pesë dokumenteve të miratuar për vitin 2023, që i janë nënshtruar konsultimit publik ka qenë në nivel shumë të mirë.

Në konsultimin e tyre janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh. Dokumenti ka patur forume të ndryshme konsultimi, si RENjK dhe tryezat e përbashkëta e nëpërmjet tyre janë sjellë komente dhe feedback nga institucionet dhe shoqëria civile si dhe ndërgjegjësimin për çështjet në fusha të ndryshme të aktivitetit shoqëror.

Sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose jo dhe pse.

Gjithashtu, raportet e konsultimit publik janë publikuar në RENjKP, në seksionet e secilit prej akteve. Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit qeveritar, sigurohet informacion i mjaftueshëm për konsultime të gjera me palët e interesit si dhe ruhen prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, nëpërmjet publikimit të tyre në RENjKP. Gjithashtu, një shkallë e mirë e reflektimit të reagimeve të palëve të interesuara pasqyrohet në draftin e ri.

Për sa më sipër, institucioni vetëvlerësohet me numrin maksimal të pikëve, 8, pasi projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit, janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre dhe në draftet e reja të projektligjeve pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat mbeten përdorimi i RENjKP dhe përfshirja e sa më shumë aktorëve joqeveritarë.

Takimet konsultative të tipit Hibrid (online dhe takime ballë për ballë) mendojmë që janë te vlefshme sepse kursejnë kohën e pjesëmarrësve dhe sigurojnë pjesëmarrje pothuaj të plote të të ftuarve.

Një trend pozitiv është numri i lartë i pjesëmarrësve të pranishëm (jo thjesht të ftuar). Kjo tregon interes nga popullsia për të diskutuar mbi çështjet madhore të shoqërisë. Sidoqoftë mbetet sfida që të pranishmit ta shprehin angazhimin nëpërmjet komenteve dhe jo thjesht pjesëmarrjes.